



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS
GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE
ANNUAL PERFORMANCE REPORT

2016

Prishtinë, Prill 2017



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2016

Prishtinë, Prill 2017

Tabela e përmbajtjes

FJALORI I SHPREHJEVE.....	3
FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	4
Misioni dhe Vizioni i ZKA-së.....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	7
1 Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.....	9
2 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit.....	11
2.1 Pavarësia dhe korniza ligjore.....	11
2.2 Qeverisja e brendshme dhe etika.....	12
2.2.1 Planifikimi strategjik.....	12
2.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ.....	12
2.3 Mbulimi i auditimit dhe raportimi.....	14
2.3.1 Fushë veprimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit.....	14
2.3.2 Numri dhe lloji i raporteve të auditimit.....	15
2.3.3 Standardet e auditimit të rregullsisë dhe kontrolli i cilësisë.....	16
2.3.4 Ndikimi i auditimit në menaxhimin e financave publike.....	18
2.3.5 Auditimi i performancës.....	20
2.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse.....	21
2.4.1 Burimet financiare.....	21
2.4.2 Pasuritë.....	26
2.5 Burimet njerëzore dhe trajnimet.....	26
2.5.1 Trajnimi profesional i stafit.....	29
2.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit.....	31
3 Fokusi i aktiviteteve të ZKA-së gjatë vitit 2017.....	33
4 Llogaridhënia e ZKA-së.....	36
Shtojca 1: Struktura organizative 2016/2017.....	37
Shtojca 2: Numri dhe lloji i auditimeve.....	38
Shtojca 3: Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2016 dhe adresimi i rekomandimeve për vitin 2015.....	40

FJALORI I SHPREHJEVE

AP	Auditori i Përgjithshëm
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
OB	Organizata Buxhetore
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TI	Teknologjia Informativë
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM



Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes para Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2016. Paraqitja e Raportit koïncidon me vitin e parë të punës sime si Auditor i Përgjithshëm.

Raporti i performancës së aktiviteteve të ZKA-së, për vitin 2016, për herë të parë është përgatitur duke u bazuar në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës që zakonisht përdoret nga Institucionet Supreme të Auditimit në matjen dhe raportimin e rezultateve të tyre përpara Kuvendit dhe qytetarëve.

Viti 2016 ishte vit i ndryshimeve dhe sfidave të gjithanshme për Zyrën Kombëtare të Auditimit. Krahas ndryshimeve në menaxhmentin e lartë të institucionit, ka ndryshuar edhe legjislacioni kryesor që rregullon veprimtarinë e ZKA-së.

Mandatin tim si Auditor i Përgjithshëm e kam filluar më 31 mars 2016, në fazën më intensive të sezonit auditues 2015/2016. Prandaj, prioriteti im i parë ishte përfundimi i të gjitha auditimeve të rregullsisë brenda afatit ligjor dhe me cilësinë e duhur. Paralelisht me këtë, pashmangshëm duhej filluar procesi i menaxhimit të ndryshimit organizativ, pasi që institucioni po përballej me ndryshime të rëndësishme si brenda ashtu edhe në rrethinën e tij, pas një periudhe të gjatë të operimit pa kreun e saj.

Duke ofruar këtë përmbledhje njëvjeçare të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe të punës sime si Auditor i Përgjithshëm, kam kënaqësinë t'ju informoj që kemi arritur të përmbushim me sukses të plotë mandatin ligjor. Gjatë periudhës raportuese, kemi arritur të përfundojmë brenda afatit dhe me cilësinë e duhur, të gjitha raportet e auditimit të rregullsisë të planifikuara me planin vjetor të auditimit për sezonin 2015/2016. Kemi publikuar 91 raporte të auditimit të rregullsisë, pesë raporte të auditimit të performancës dhe dy raporte të auditimit të projekteve të financuara nga donatorët.

Duke pasur si vizion rritjen e vazhdueshme të cilësisë së punës sonë, bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit, besoj që Zyra Kombëtare e Auditimit përmes raporteve të auditimit dhe këshillave të drejtpërdrejta, u ka ofruar përkrahje praktike autoriteteve publike për veprimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e qeverisjes dhe ndërtimin e një sistemi efikas për menaxhimin e shëndosh financiar.

Megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm. Nga rreth 1,200 rekomandime që ishin dhënë në raportet e vitit 2015, vetëm 30% e tyre janë zbatuar plotësisht. Një performancë më të kënaqshme kanë shfaqur institucionet e pavarura, ndërsa përmbushja e rekomandimeve nga komunat mbetet në një nivel të ulët. Me qëllim të rritjes së shkallës së implementimit të rekomandimeve, me Raportin Vjetor të Auditimit 2015, i kam rekomanduar Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë mbi progresin e arritur në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Për sezonën audituese 2016/2017, numri i auditimeve është rritur në krahasim me vitin paraprak. Janë planifikuar dhe janë duke u finalizuar 96 auditime të rregullsisë, përfshirë edhe katër auditime të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike. Po ashtu janë përfunduar ose janë në

proces të përgatitjes edhe 17 auditime të performancës të fushave të ndryshme si arsimi, shëndetësia, mjedisi, zhvillimi ekonomik, dhe sistemet e teknologjisë së informacionit.

Për të zbatuar në praktikë Ligjin e ri për ZKA-në, kemi hartuar aktet përkatëse nën ligjore të cilat po gjejnë zbatim dhe po japin rezultate të mira. Kemi hartuar Kodin e ri të Etikës dhe Mirësjelljes si dhe akte të tjera administrative të nevojshme për punën tonë.

Gjatë vitit 2016, është bërë një riorganizim i strukturës organizative me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të burimeve njerëzore dhe arritjes së objektivave strategjike të organizatës. Me organizimin e ri, janë shtuar funksionet për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim i cili ka përgjegjësinë për rishikimin dhe kontrollin e cilësisë në të gjitha fazat e procesit të auditimit dhe funksionet e Auditimit të Ndërmarrjeve Publike. Ky riorganizim përveç që ka plotësuar kërkesat ligjore, ka ndikuar që të rritet mbulueshmëria në auditim, rritet siguria dhe të ulen kostot operative.

Vëmendje e posaçme i është kushtuar investimit në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore. Përveç trajnimeve të vazhdueshme profesionale brenda vendit, një numër i konsiderueshëm i stafit ka ndjekur trajnime edhe jashtë vendit, të organizuara nga institucionet partnere dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit.


Gjatë periudhës raportuese, ZKA ka intensifikuar bashkëpunimin me palët e interesit në vend dhe jashtë vendit. Është forcuar bashkëpunimi me institucionet e drejtësisë dhe është rritur ndjeshëm komunikimi me organizatat e shoqërisë civile, me synimin që ky komunikim të jetë i rregullt dhe i vazhdueshëm përmes një Forumi konsultativ. Po ashtu, kemi marrë pjesë në aktivitetet në kuadër të Rrjetit të ISA-ve, të Komitetit të Kontaktit (ISA-të e vendeve të BE-së dhe anëtarët e Gjykatës Supreme të Auditorëve), në Kongresin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe të asaj evropiane (EUROSAI), etj.

Fokusi jonë në aktivitetet e ardhshme do të jetë i orientuar në rritjen e cilësisë dhe numrit të auditimeve të rregullsisë dhe të performancës; në finalizimin e legjislacionit sekondar; në ngritjen dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të brendshme; në thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin, shoqërinë civile si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me ISA-të tjera dhe përgatitjet për procesin e anëtarësimit në organizatat rajonale e ndërkombëtare të ISA-ve.

Dëshiroj me këtë rast të falënderoj organizatat partnere si: Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe të Britanisë së Madhe, Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë si dhe donatorët: BE, USAID, GIZ, DEMOS për përkrahjen e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve tona dhe integrimin në aktivitetet e organizatave dhe forumeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit.

Më lejoni po ashtu të shpreh respektin për stafin e ZKA-së dhe për subjektet e audituara që kanë punuar së bashku për përmbushjen e objektivave audituese, në interes të përmirësimit të qeverisjes në institucionet publike në Kosovë.

Prishtinë, 30 prill 2017



Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Misioni dhe Vizioni i ZKA-së

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA-ja) është institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut. ZKA-ja është e përkushtuar në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues e ligjor me një vizion të qartë drejt së ardhmes.

Misioni

Të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike duke kryer auditime cilësore në pajtim me kornizën ligjore dhe standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht si dhe duke aplikuar praktikat e mira evropiane.

Vizioni

Si institucion suprem i auditimit të ndihmoj institucionet e Kosovës në shfrytëzimin racional të parasë publike, në ngritjen e qeverisjes së mirë dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.

Veprimtaria e ZKA-së:

- kryen auditime për të siguruar se qeveria dhe entitetet e sektorit publik janë përgjegjëse për përdorimin dhe administrimin e fondeve publike;
- forcon përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin duke audituar në mënyrë të pavarur aktivitetet e sektorit publik dhe duke raportuar gjetjet e tyre;
- iu mundëson zyrtarëve të ngarkuar me qeverisjen e sektorit publik, të përmbushin përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur gjetjeve të auditimit, rekomandimeve dhe duke marrë masa korigjuese të përshtatshme; dhe
- raporton mbi rezultatet e auditimit, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë publikut të shikoj dhe të monitoroj përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të entiteteve të sektorit publik.

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i performancës së aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2016, bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA). Kjo kornizë përdoret nga ISA-të në matjen dhe raportimin e rezultateve të tyre përpara Kuvendit dhe qytetarëve.

Fusha e parë e Kornizës së Matjes së Performancës së ISA-ve është **“Pavarësia dhe Korniza Ligjore”**.

Ligji i ri i për “Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit” i miratuar në vitin 2016 ka forcuar pavarësinë funksionale, financiare dhe operative si parakusht për përmbushjen e mandatit kushtetues e ligjor të Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së.

Për të zbatuar në praktikë Ligjin e ri për ZKA-në, u hartuan aktet nën ligjore si: Rregullore për Marrëdhënie Pune dhe Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ZKA.

Indikatorët matës për fushën **“Qeverisja e mirë dhe Etika”**, tregojnë se për përmbushjen e vizionit të ZKA-së është hartuar “Plani Zhvillimor Korporativ 2015-2020”, që përcakton orientimin strategjik të institucionit me synimin që të arrihet qëndrueshmëria institucionale, të ruhet dhe ngritët më tej cilësia e qeverisjes korporative dhe cilësia e auditimit dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në përmirësimin e qeverisjes në vend. Ky dokument strategjik do të rishikohet dhe përshtatet me legjislacionin e ri duke marrë parasysh edhe trendet e zhvillimit të auditimit të jashtëm.

ZKA ka bërë përshtatje të strukturës organizative me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të gjitha burimeve të saj, për arritjen e objektivave strategjike të organizatës.

Mbi bazën e parimeve të Kodit të Etikës të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Ligjit të ri është hartuar Kodi i ri i Etikës dhe Mirësjelljes që riafirmon vlerat dhe pasqyron parimet thelbësore në të cilat bazohet veprimtaria e ZKA-së.

ZKA-ja vepron mbi themelet e transparencës dhe të llogaridhënies. Për të qenë një organizatë model, ka ndërtuar një komunikim efektiv si në rrugë vertikale ashtu edhe në atë horizontale.

Indikatorët matës për fushën **“Mbulimi i auditimeve dhe raportimi”** janë rezultatet e auditimit të rregullsisë, të performancës dhe ndikimi i tyre që i shtojnë vlerë menaxhimit financiar të institucioneve publike.

Gjysmën e parë të vitit 2016 e karakterizon një punë intensive e përfundimit të auditimeve të rregullsisë për vitin 2015. Kemi publikuar 91 raporte të auditimit të rregullsisë, pesë raporte të auditimit të performancës dhe dy raporte auditimi të projekteve të financuara nga donatorët. Detajet për këto raporte janë të prezantuar më poshtë në këtë Raport.

Një nga treguesit kryesor të matjes së performancës së auditimit është shkalla e zbatimit të rekomandimeve. Me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve, me Raportin Vjetor

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

të Auditimit 2015, Auditori i Përgjithshëm i ka rekomanduar Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë për progresin e arritur në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Mbi bazën e pavarësisë funksionale, në fillim të çdo sezoni të auditimit, ZKA-ja harton planin vjetor të auditimit. Për sezonën audituese 2016/2017, numri i auditimeve është në rritje në krahasim me vitin paraprak. Janë planifikuar 96 auditime të rregullsisë, përfshirë edhe katër auditime të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike.

Meqë, auditimi i performancës promovon përgjegjshmërinë duke ndihmuar të ngarkuarit me qeverisje dhe përgjegjësi mbikëqyrjeje të përmirësojnë performancën, ZKA-ja po përballlet me një sfidë për të përqendruar punën tek auditimet e performancës. Për sezonën audituese 2016/2017, janë planifikuar 17 auditime të performancës të fushave të ndryshme si arsimi, shëndetësia, mjedisi, zhvillimi ekonomik, dhe sistemet e teknologjisë së informacionit.

Sipas indikatorit matës **“Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse”**, ZKA-ja i menaxhon operacionet e veta me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Pasqyrat financiare të ZKA-së publikohen dhe janë subjekt i auditimit të jashtëm të pavarur. ZKA bën publik buxhetin mbi burimet financiare dhe raporton për përdorimin e këtyre burimeve.

“Burimet njerëzore dhe trajnimet”. ZKA-ja ka vijuar të investojë në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore. Trajnimi i vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit është parë si një mënyrë për të kontribuar në cilësi më të mirë dhe qasje efektive për ngritjen e kapaciteteve.

“Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit” është një nga objektivat strategjike të ZKA-së. Ky bashkëpunim me palët e interesit bëhet përmes Rrjetit të ISA-ve, Komitetit të Kontaktit, INTOSAI dhe EUROSAL. Synimi i ZKA-së është anëtarësimi me të drejta të barabarta në këto organizata dhe grupime.

Fokusi jonë në aktivitetet e ardhshme do të jetë i orientuar në rritjen e cilësisë dhe numrit të auditimeve të rregullsisë dhe të performancës; në finalizimin e legjislacionit sekondar; në ngritjen dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të brendshme; në thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin; shoqërinë civile; intensifikimin e bashkëpunimit me ISA-të tjera dhe përgatitjet për procesin e anëtarësimit në organizatat rajonale e ndërkombëtare të ISA-ve.

1 Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit

Hyrje

Auditori i Përgjithshëm është një institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Zyra Kombëtare e Auditimit ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 05/L-055 "Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës".

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë së ZKA-së nga organizatat të cilat i auditon është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm dhe ligjor, pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kodi të brendshëm për mirësjellje profesionale.

Aktiviteti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

ZKA kryen auditime të rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë ekzekutive, komunitat, organet e pavarura dhe entitetet tjera.

ZKA kryen po ashtu auditime të rregullsisë në Ndërmarrjet publike.

ZKA kryen auditime të performancës, të projekteve të financuara nga fondet donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe auditime të sistemeve të TI. Këto auditime kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

ZKA raporton për auditimet e saj tek Kuvendi, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP). Raportet individuale të auditimit u dërgohen entiteteve të audituara dhe publikohen në uebfaqen e ZKA-së. Raportet e auditimit përmbajnë rekomandime me qëllim nxitjes së ndryshimit dhe zbatimit të praktikave më të mira. Me këtë duam që t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë dhe taksapaguesve një shërbim auditimi profesional të bazuar në fakte dhe të integruar.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Këtë do ta bëjmë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Procesi i llogaridhënies

Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato duhet të jenë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik mbi bazën e parasë së gatshme. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit do të angazhoj një firmë të jashtme të pavarur dhe të pranuar ndërkombëtarisht që të kryejë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të ZKA-së. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së.

Përveç auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga Njësia për Auditim të Brendshëm sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm që ZKA-ja vepron në pajtueshmëri me ligjet, aktet e brendshme nënligjore dhe politikat e veta.

Kush do të rishikojë financimin e ZKA-së?

ZKA përgatit dhe dorëzon çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) mund të kërkojnë sqarimet e nevojshme për kërkesën buxhetore të ZKA-së dhe për të diskutuar mbi planet, prioritetet, objektivat e performancës, raportimin vjetor të performancës, dhe praktikat tona të menaxhimit.

Qeveria inkorporon kërkesën buxhetore të ZKA-së në Buxhetin e propozuar të Kosovës dhe mund të jap komente për të në një dokument të veçantë. Buxheti i ZKA-së miratohet nga Kuvendi.

2 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Korniza e Matjes së Performancës, si dokument standard i INTOSA-it ka 25 tregues për të matur performancën e ISA-ve të grupuara në gjashtë fusha:

- A) Pavarësia dhe Korniza ligjore;
- B) Qeverisja e Brendshme dhe Etika;
- C) Mbulimi i Auditimit dhe Raportimi;
- D) Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse;
- E) Burimet njerëzore dhe Trajnimet;
- F) Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit.

Raporti i Performancës së ZKA-së, për vitin 2016, është kryer bazuar në këtë dokument standard dhe ka përcaktuar 15 tregues kryesor performance të fushave të sipërpërmndura. Matja e tillë e performancës mundëson që të identifikojmë pikat e forta dhe të dobëta të punës audituese si dhe të menaxhimit të organizatës.

Matja e punës nëpërmjet treguesve të performancës sipas Kornizës së Matjes së Performancës, të cilët përmbledhin standardet SNISA dhe praktikat e mira të përcaktuara nga INTOSAI jep një pasqyrë të aktiviteteve dhe rezultateve të fushave të një ISA. Matjet objektive të performancës në formë të treguesve matës, e bëjnë të mundur krahasimin e performancës së aktiviteteve të një ISA me institucionet tjera simotra.

2.1 Pavarësia dhe korniza ligjore

Kjo fushë mbulon Pavarësinë dhe Kornizën Ligjore të ZKA-së. SNISA 1 (Deklarata e Limës) dhe SNISA 2 (Deklarata e Meksikës dhe Pavarësia e ISA-së) është baza e praktikave të mira për këtë fushë. Indikatorët matës që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia dhe mandati i ZKA-së.

Pavarësia e Auditorit të Përgjithshëm dhe e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm e që është bazë për organizimin, funksionimin dhe mandatin e tij në kryerjen e auditimeve.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit” nga qershori i vitit 2016, është konsoliduar pavarësia funksionale, financiare dhe operative. Auditori i Përgjithshëm dhe ZKA-ja ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Standardet e Auditimit në sektorin publik të njohura ndërkombëtarisht. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Një mandat i tillë është baza e punës së Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së që për kryefjalë ka pavarësinë funksionale, financiare dhe operative. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari vetëm Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, ligj, dhe në standardet e auditimit të sektorit publik.

Progresi pas miratimit të Ligjit nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës”

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri, Auditori i Përgjithshëm me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, filloi me hartimin e rregulloreve të brendshme për të përcaktuar organizimin dhe menaxhimin e brendshëm të ZKA-së. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar: Rregullorja për Marrëdhënie Pune, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ZKA, Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, etj.

2.2 Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë mbulon qeverisjen e brendshme dhe etikën e ZKA-së. Indikatorët matës që ZKA ka aplikuar janë: Planifikimi strategjik, mjedisi i kontrollit organizativ, komunikimi i brendshëm dhe planifikimi i auditimeve.

Objektivë e ISA-ve duhet të jetë promovimi i transparencës dhe llogaridhënies përmes mirëqeverisjes dhe etikës për të përmbushur mandatin e tyre.

2.2.1 Planifikimi strategjik

Që një organizatë të jetë e suksesshme është e nevojshme që të përcaktohen objektivat më të rëndësishme të saj në kuadër të një plani strategjik. Për përmbushjen e vizionit të saj, ZKA-ja ka hartuar “Planin e Zhvillimit Korporativ 2015-2020”. Ky dokument përmban tri shtylla të cilat adresojnë qëndrueshmërinë institucionale, kontributin në forcimin e qeverisjes së mirë dhe ruajtjen dhe ngritjen e cilësisë së qeverisjes korporative dhe të auditimit.

2.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ

ISA duhet të ketë një sistem të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e saj ekonomike i menaxhon në mënyrë efikase dhe ekonomike në përputhje me ligjet dhe rregulloret sipas Standardit të Qeverisjes 9100 të INTOSAI-t. Përveç kësaj, ISA duhet të ketë edhe një sistem të kontrollit të cilësisë që e siguron cilësinë e gjithë punës së saj (SNISA 40).

Në funksion të këtyre janë ndërmarrë disa hapa konkret:

Ndryshimet e strukturës organizative

Për të përmbushur pritjet nga ZKA-ja, Auditori i Përgjithshëm ka bërë një përshtatje të re të strukturës organizative me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të organizatës.

Për të forcuar kontrollin e cilësisë në auditim, në linjë me standardin ISSAI 40 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë”, me strukturën e re organizative u krijua Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim si divizion i veçantë. Po ashtu, në funksion të arritjes së objektivave të ZKA-së, u krijuan edhe dy departamente të reja: Departamenti për auditimin e ndërmarrjeve publike dhe Departamenti për auditimin e projekteve. Ndërsa si pjesë e departamentit të performancës ka hyrë edhe auditimi i sistemeve të TI.

Rregullorja e re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, përmban rregullat për organizimin dhe funksionimin e ZKA-së.

Hartimi i Kodit të ri të Etikës së ZKA-së

ZKA-ja ka hartuar Kodin e ri të Etikës dhe Mirësjelljes, i cili u miratua nga Auditori i Përgjithshëm në tetor të vitit 2016 bazuar në parimet që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t.

Kodi i ri i Etikës dhe Mirësjelljes riafirmon vlerat dhe pasqyron parimet thelbësore në të cilat bazohet veprimtaria jonë. Këto vlera dhe parime përmbajnë nga njëra anë shtyllat e besueshmërisë institucionale dhe nga ana tjetër, janë të lidhura ngushtë me të kuptuarit e ZKA-së si një institucion kushtetues në shërbim të llogaridhënies, qeverisjes së mirë dhe transparencës.

Në funksion të arritjes së sigurisë së mjaftueshme, ZKA-ja ka krijuar politika dhe procedura, të cilat kërkojnë që gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike më të rëndësishme duke nënshkruar Kodin e etikës dhe Deklaratën e pavarësisë profesionale.

Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm me punonjësit, duke i dhënë mundësi secilit punonjës të shprehet hapur si në rrugë vertikale ashtu edhe në atë horizontale për çështjet që lidhen me punën e tyre si dhe për ato brenda institucionit. AP mban takime të rregullta javore me menaxhmentin e lartë të ZKA-së si dhe takime mujore me drejtorët e departamenteve. Këta të fundit dorëzojnë raporte javore për aktivitetet e departamenteve. Për më tepër, brenda ZKA-së funksionon edhe rrjeti i Intranetit që lehtëson komunikimin në mes të departamenteve.

Planifikimi i auditimit

Auditimet janë bërë në përputhje me një program të vet-përcaktuar. Bazuar në këtë, kemi hartuar Planin Vjetor të Auditimit në fillim të sezonës audituese. Në hartimin e Planit kemi marrë në konsideratë përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkesave specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, si donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që kemi pasur në dispozicion.

2.3 Mbulimi i auditimit dhe raportimi

Treguesit e kësaj fushe ndërlidhen kryesisht me fushëveprimin e auditimeve sipas llojit të tyre, mbulimit të auditimeve sipas llojit dhe në numër, adresimi i rekomandimeve nga organizatat buxhetore, raportimi i rezultateve të auditimeve dhe ndikimi i auditimeve të ZKA-së në menaxhimin e financave publike.

2.3.1 Fushë veprimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit

Në përputhje me fushëveprimin e saj ZKA kryen dy lloje të auditimeve:

- Auditime të rregullsisë
 - të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme);
 - të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual);
- Auditime të performancës, përfshirë auditimet e projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, sipas kërkesës.

Auditimet e rregullsisë: përfshijnë auditimin e PFV-ve dhe llogarive kryesore të institucionit të audituar, me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe llogaritë pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Këto auditime kryhen çdo vit dhe raportohen në një afat të caktuar kohor. Auditimet fillojnë në shtator, memot e auditimit dorëzohen në dhjetor ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

ZKA-ja po ashtu kryen auditime të rregullsisë në Ndërmarrjet publike, bazuar në sistemin aktual.

Auditime të performancës: është një ekzaminim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektiviteti (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Këto auditime përfshijnë tema të ndryshme në fushën e arsimit, shëndetësisë, prokurimit, infrastrukturës, social ekonomike, teknologjisë informative. Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohet prej rastit në rast (nuk lidhet me një afat të caktuar kohor), duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditime të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare

Këto auditime kryhen në bazë të marrëveshjes me donatorët dhe/ose përfituesit e tyre. Për këto auditime ZKA aplikon një tarifë, ndërsa fondet e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Përmes auditimeve dhe aktiviteteve tjera këshilluese, ZKA e mbështet llogaridhënien dhe transparencën e organizatave të audituara në përdorimin e parasë publike, pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, qeverisjen e mirë, arritjen e vlerës për para si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

2.3.2 Numri dhe lloji i raporteve të auditimit

Deri në fund të vitit 2016, ZKA ka përfunduar dhe publikuar:

- Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës (për vitin 2015);
- 90 raporte të auditimit të rregullsisë (për vitin 2015);
- 5 raporte të auditimit të performancës;

Për sezonën audituese 2016/17 janë planifikuar:

- Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës (për vitin 2016);
- 95 auditime të rregullsisë për vitin 2016 janë në proces (përfshirë 4 ndërmarrje publike). Raportet do të publikohen më së voni deri më 30 qershor 2017;
- 17 auditime të performancës janë në proces. Raportet do të publikohen gjatë vitit 2017; dhe
- 2 auditime të projekteve të financuara nga donatorët (të përfunduara).

Përmes auditimit të rregullsisë kemi arritur ti mbulojmë të gjitha OB-të me përjashtim të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Numri i auditimeve të rregullsisë dhe të performancës është duke u rritur, ndërsa presim poashtu që të auditojmë më shumë projekte të financuara nga donatorët dhe huamarrja në të ardhmen.

Tabela 1 tregon portofolin e përgjithshëm të auditimit, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për dy vitet e fundit. Për më shumë detaje rreth raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces, referojuni Shtojcës 2 të këtij Raporti.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara dhe të kryera gjatë dy sezoneve të fundit të auditimit

Llojet e auditimit	Sezoni i auditimit	
	2016/2017	2015/2016
Auditime të rregullsisë	96	91
- Buxheti i Kosovës	1	1
- Institucione qendrore	24	24
- Institucione të pavarura	30	28
- Komuna	38	38
- Të kontraktuara	-1 ¹	-6 ²
- Ndërmarrje publike (sistemi aktual)	4	0
Auditime të performancës dhe të projekteve	19	7
- Auditime të performancës	17	5
- Auditime të projekteve	2	2
Gjithsej	115	98

Për dallim nga sezoni i kaluar i auditimit kur ishin kontraktuar 6 entitete, në këtë sezonë janë në proces të auditimit të gjitha OB-të përveç Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), auditimi i së cilës do të kryhet nga një firmë private e auditimit.

2.3.3 Standardet e auditimit të rregullsisë dhe kontrolli i cilësisë

Me qëllim të arritjes së objektivit për kryerjen e auditimeve në përputhje me SNISA të INTOSA-it, ZKA ka ndërmarrë disa hapa konkret në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme rregullative dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Azhurnimi i Doracakut të Auditimeve të rregullsisë

Në kuadër të zbatimit të SNISA-ve, është bërë azhurnimi i Doracakut të Auditimeve të Rregullsisë duke iu përshtatur kërkesave të ndryshimeve të bëra në SNISA. Qëllimi kryesor i këtij Doracaku është që t'i ofrojë secilit auditues një pikë referuese për ta ndihmuar gjatë gjithë procesit të auditimit të rregullsisë. Kjo nuk ka për qëllim të zëvendësojë ushtrimin e gjykitimit profesional i cili është parakusht për kryerjen e suksesshme të auditimit.

Metodologjia e auditimit, lehtëson dhe përmirëson cilësinë e auditimeve, si dhe është projektuar për të përmbushur standardet e aplikueshme ndërkombëtare. Për të siguruar cilësi të lartë të punës së auditimit të rregullsisë, Doracaku ofron një kornizë për planifikim, ekzekutim dhe raportim mbi auditimet, duke e theksuar rëndësinë e fokusimit në rrezik, për të kryer auditime efektive dhe efikase dhe për ta mbrojtur dhe ngritur reputacionin e ZKA-së.

¹ Për vitin 2016, ZKA ka kontraktuar një kompani private të auditimit për mbulimin të një ministrie.

² Në nivel të qeverisjes lokale, janë kontraktuar kompani private të auditimit për mbulimin e auditimit të gjashtë komunave.

Synimet e këtij azhurnimi janë projektuar posaçërisht që të arrihet: zhvillimi i një metodologjie të auditimit që përdoret nga i gjithë stafi i ZKA-së për auditimet e rregullsisë; promovimi i kryerjes së vazhdueshme të auditimeve me cilësi të lartë, të efektshme dhe efikase; sigurimi i pajtueshmërinë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA); fuqizimi i qasjes së auditimit dhe mjeteve për t'u përshtatur me të gjitha angazhimet audituese.

Kontrolli i cilësisë

Sipas parimit bazë të SNISA 40 "Kontrolli i Cilësisë", një ISA duhet të hartojë politika dhe procedura për të nxitur një kulturë të brendshme, e cila pranon se cilësia është thelbësore për të gjithë punën e saj.

Bazuar në këtë parim një ndër objektivat kryesore të ZKA-së ka qenë dhe mbetet kontrolli i cilësisë që ka për qëllim që të identifikojë mangësitë, përmirësimet që duhen ndërmarrë në të ardhmen, me qëllim të përmirësimit në vazhdimësi të punës në zbatimin e standardeve të auditimit.

Për sezonën e auditimit 2015/2016, ne kemi bërë:

- Monitorimin e cilësisë në 17 auditime të rregullsisë për PFV të vitit 2015, për të gjitha fazat e auditimit: planifikim, ekzekutim dhe raportim; dhe
- Monitorimin e cilësisë për 12 auditime pilot, për PFV të vitit 2015.

Në zbatim të këtij standardi, AP-ja, me strukturën e re organizative themeloi një divizion të veçantë për kontrollin e cilësisë me qëllim që të rishikohet i tërë procesi i auditimit në të gjitha fazat e tij.

Gjatë sezonit të auditimit 2016/2017, kanë përfunduar ose janë në proces të rishikimit:

- 79 dosje të auditimit për fazën e planifikimit;
- 50 dosje të auditimit për fazën e ekzekutimit;
- 30 memorandume të auditimit;
- 50 raporte përfundimtare të auditimit.

Sipas rezultateve nga dosjet e shqyrtuara, konstatohet se krahas rezultateve të arritura të sigurimit të cilësisë janë konstatuar edhe disa përmirësime të cilat do të ndikojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë për të gjitha fazat e auditimit. Prandaj, çdo vit bazuar në mësimet e nxjerra, janë bërë ndryshime pozitive në mënyrën se si janë kryer auditimet dhe se si janë raportuar rezultatet.

Në këtë mënyrë, cilësia e përgjithshme e punës dhe e produkteve tona është përafëruar me kërkesat e SNA-së të ISA-ve dhe praktikat e mira evropiane, ndonëse ende ka për t'u bërë.

2.3.4 Ndikimi i auditimit në menaxhimin e financave publike

Ndikimi i auditimeve pasqyrohet me kursimet dhe përmirësimet në sistemin e menaxhimit të financave publike dhe të performancës së përgjithshme në nivele të ndryshme të qeverisjes.

Në raportet e auditimeve gjatë vitit 2016 rëndësi e posaçme i është dhënë Qeverisjes së mirë duke identifikuar praktika të mira dhe duke i shpërndarë ato me organizatat tjera të sektorit publik.

Gjatë vitit 2016, ne gjithashtu kemi përkrahur KMFP dhe grupet punuese ndërqeveritare si dhe ju kemi dhënë mbështetje të drejtpërdrejtë organizatave të audituara. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me institucionet e drejtësisë.

Përkrahja e Kuvendit dhe pjesëmarrja në grupet punuese

- Kemi përkrahur KMFP të Kuvendit të Kosovës në shqyrtimin e 14 raporteve të auditimit³. Kjo përkrahje është dhënë përmes përgatitjes së përmbledhjeve dhe ofrimit të sqarimeve në takime përgatitore. Si rezultat i këtyre shqyrtimeve KMFP ka nxjerrë 9 rekomandime specifike për OB-të lidhur me këto raporte. Qëllimi ynë i përbashkët është që brenda sistemit të llogaridhënies, shpenzuesit buxhetor të mbahen përgjegjës për zhvillimin e aktiviteteve publike në përputhje me ligjin dhe standardet e auditimit në mënyrë që paraja publike të përdoret në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive;
- Kemi marrë pjesë në konferencën me komunitet me temën “Performanca financiare, shërbimet e ofruara qytetarëve dhe llogaridhënia në nivelin lokal për vitin 2015” dhe në një takim pune me komunitet qendror të Regjionit të Prishtinës me temën “Çështjet kryesore të dala nga raportet e auditimit 2015”. Këto takime janë organizuar nga OSBE; si dhe
- Kemi marrë pjesë aktive në grupin punues për “Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike”.

Bashkëpunimi me organet e drejtësisë

- Auditori i Përgjithshëm dhe Kryeprokurori i Shtetit kanë bërë koordinimin e aktiviteteve ndër institucionale lidhur me detyrimet e përcaktuara ligjore. ZKA informon Zyrën e Prokurorit të Shtetit në lidhje me rastet indikative me elemente të veprave penale të cilat hasen gjatë punës audituese;
- ZKA bashkëpunon me Agjencinë Kundër Korrupsionit, me qëllim të ofrimit të informatave shtesë dhe sqarimeve lidhur me trajtimin e të gjeturave në raportet e auditimit;
- ZKA-ja bashkëpunon edhe me Njësinë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës. Sipas kërkesave të kësaj Njësie, ZKA-ja ofron të dhëna dhe dokumente relevante të siguruar në proceset e auditimit për rastet e caktuara të cilat trajtohen nga hetuesia;
- ZKA-ja, në raport me organet e drejtësisë dhe Njësinë përkatëse të Policisë së Kosovës, vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin e fushës penale.

³ 11 raporte të auditimit të rregullsisë, 1 raport të auditimit të performancës, Raportin Vjetor të Auditimit dhe Raportin Vjetor të Performancës, të gjitha për vitin 2015.

Numri dhe përqindja e rekomandimeve të zbatuara

Një nga treguesit kryesor të matjes së performancës së auditimit është shkalla e zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në standardet e auditimit përcjellja e zbatimit të rekomandimeve është një nga aktivitetet e ZKA-së. Në raportet e auditimit të vitit 2015 kemi raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve i kemi përmbledhur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 2: Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2015 për vitin 2014

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna		Të zbatuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
Institucionet qendrore	347	133	38	118	34	96	28	
Institucionet e pavarura	200	94	47	57	29	49	24	
Komunat	630	129	20	243	39	258	41	
Totali	1,177	356	30	418	36	403	34	

Tabela 3: Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2014 për vitin 2013

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna		Të zbatuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
	Nr	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
Institucionet qendrore	313	96	29	95	31	119	30	
Institucionet e pavarura	199	104	31	37	12	61	16	
Komunat	521	136	40	172	57	213	54	
Totali	1,033	336	33	304	29	393	38	

Zbatimi i rekomandimeve nga institucionet e nivelit qendror dhe nga institucionet e pavarura është më i lartë në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa zbatimi i rekomandimeve nga komunat është më i ulët se në vitin paraprak.

Përveç rekomandimeve të lartpërmendura, kemi dhënë këshilla përmes memorandumeve të auditimit (gjatë fazës së ndërmjetme të auditimit) për përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe raportimin financiar. Si rezultat, PFV-të e OB-ve ishin të cilësisë më të mirë për dallim nga pasqyrat financiare nëntëmujore.

Gjithashtu, kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për kuvendet komunale. Nga 57 rekomandime të dhëna, vetëm 10 janë zbatuar plotësisht, 24 janë në proces dhe 23 të tjera nuk janë adresuar ende (për më tepër referojuni Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2015, shtojca III).

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Bazuar në shkallën e lartë të rekomandimeve të pa adresuara, në RVA për vitin 2015, Auditori i Përgjithshëm ka rekomanduar Kuvendin që të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2014, dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA të vitit 2015 dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza tremujore.

Si rezultat i këtyre rekomandimeve të AP-së, Kuvendi i Kosovës pasi që ka shqyrtuar rekomandimet e KMFP lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit të ZKA-së për vitin 2015, në dhjetor të vitit 2016 ka miratuar rekomandimet që Qeveria të: përgatisë raport kthyes në lidhje me rekomandimet e AP-së për RVA për vitin 2014; përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve nga RVA për vitin 2015 si dhe të raportojë në baza tremujore mbi progresin e arritur në KMFP; që të gjitha OB-të të raportojnë mbi procesin sistematik të zbatimit të rekomandimeve në baza tremujore në Ministri të Financave dhe në KMFP.

2.3.5 Auditimi i performancës

Gjatë vitit 2016, janë publikuar 5 raporte të auditimit të performancës të fushave të ndryshme me interes ekonomik, shoqëror në aspektin e mbulimit të çështjeve me rëndësi që lidhen me shëndetësinë, arsimin, mjedisin, infrastrukturën, dhe sistemin e TI-së.

Trendi i auditimeve të performancës është në rritje prej vitit në vit. Me planin vjetor të auditimit për sezonin 2016/2017, janë planifikuar 17 auditime të performancës të cilat janë në proces që do të publikohen gjatë vitit 2017. Në kuadër të këtyre auditimeve, 5 janë auditime të sistemeve të TI-së dhe 4 auditime të projekteve: Marrëveshjet për shërbime të veçanta; Fondi zhvillimor; Marrëveshjet e bashkëfinancimit; dhe Investimet kapitale në ndërmarrjet publike.

Në raportet e auditimit të performancës janë adresuar mesazhet kryesore të auditimit si në vijim:

Në Raportin **“Qëndrueshmëria e masave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit”**, mesazhi i auditimit është se “Qeveria e Republikës së Kosovës ende nuk i ka dhënë vëmendje të mjaftueshme masave për mbrojtjen e mjedisit, dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tyre, përkundër ekzistimit të një kornize thuajse të konsoliduar ligjore. Trajtimi aktual i sfidave mjedisore është larg nga objektivat e synuara dhe pavarësisht kësaj, barrierat e mëdha mbeten në veprimet për trajtimin efektiv të mjedisit”.

Në Raportin **“Siguria në punë e punonjësve në sektorin e ndërtimitarisë”**, mesazhi i auditimit është se “Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ende nuk ka zhvilluar procedura adekuate për parandalimin dhe mirë-administrimin e situatave emergjente në vendin e punës. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat statistikore të cilat tregojnë se në këtë sektor krahas sektorëve tjerë vazhdon të ketë numër më të madh të vdekjeve dhe lëndimeve të punëtorëve. Për pasoj, gjendja e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendin tonë ende nuk është në nivelin e pranueshëm”.

Në Raportin **“Implementimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik”**, mesazhi i auditimit është se “Një pjesë e madhe e sistemit të e-prokurimit ende nuk është implementuar plotësisht. Shumë prej rezultateve të projektit nuk janë realizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve menaxheriale, njerëzore dhe teknike në agjencitë përgjegjëse qeveritare. Potenciali i përfitimeve të softuerit të zhvilluar dhe harduerit të implementuar mbetet shumë i nënshfrytëzuar dhe nuk është e sigurt se kjo do të përmirësohet në të ardhmen e afërt”.

Në Raportin **“Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore”** mesazhi i auditimit është se “Përkundër përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për të numëruar stoqet dhe integrimin e tyre në kërkesat për tekste të reja, komunat dhe shkollat vazhdojnë të kenë numër të konsiderueshëm stoqesh. Kthimi i teksteve shkollore vazhdon të jetë në nivel të ulët, duke rezultuar në shpenzime të larta për porositë e teksteve shkollore”.

Në Raportin **“Implementimi i rekomandimeve për Marrëveshjen e partneritetit publiko privat për ANP – Adem Jashari”**, mesazhi i auditimit është se “Prej 8 (tetë) rekomandimeve kryesore, 4 (katër) rekomandime janë adresuar, 3 (tri) janë adresuar pjesërisht dhe 1 (një) rekomandim ende nuk është adresuar. Progres është arritur në aspektin e rregulloreve dhe në legalizimin e objektit të terminalit të ri. Përderisa, ngecje ka në përfundimin e punëve të mbetura, të cilat ndërlidhen me praninë e KFOR-it brenda pronës së ANP-AJ”.

Meqë arritja dhe ruajtja e cilësisë së lartë gjatë procesit të auditimit mbetet një ndër prioritet tona kryesore, për këtë qëllim ne kemi kërkuar mbështetjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, në rritjen cilësisë së auditimeve të performancës. Aktualisht janë katër auditime të performancës të cilat janë nën mentorimin e tyre.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe azhurnimit të Doracakut për Auditime të Performancës i cili është rishikuar në të gjitha aspektet, veçanërisht kapitullit që përshkruan aspektet dhe metodologjinë që ka të bëjë me sigurimin e kontrollit të cilësisë së auditimeve të performancës. Kapitull shtesë i këtij Doracaku është edhe vlera për para në prokurimin publik. Doracaku është subjekt i vazhdueshëm i azhurnimit duke pas parasysh ndryshimet në standardet e auditimit.

2.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Burimi i financimit të aktiviteteve të ZKA-së është Buxheti i Kosovës. Gjatë vitit 2016, ZKA-ja ka pranuar donacione edhe nga partnerët ndërkombëtar që kanë mbështetur strategjinë zhvillimore të saj.

2.4.1 Burimet financiare

Bazuar Bazuar në Ligjin e Buxhetit Nr. 05/L-071 për vitin 2016, buxheti fillestar i aprovuar ishte 2,308,893€. Gjatë vitit 2016 në buxhetin e aprovuar fillestar kanë ndodhur ndryshime në të gjitha kategoritë ekonomike si në vijim:

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Paga dhe mëditje: Me Ligjin nr. 05/L-071, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në fillim të vitit në këtë kategori ekonomike është aprovuar ndarja buxhetore 1,674,604 €. Me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr. 07/112 të datës 18.10.2016, për këtë kategori aprovohet një ndarje shtesë e buxhetit në vlerë prej 30,000€. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 1,690,150€, ose shprehur në përqindje në shkallën 99%.

Mallra dhe shërbime: Me buxhetin fillestar buxheti i aprovuar për këtë kategori ishte 551,289€. Ndryshimet gjatë vitit në buxhetin fillestar ishin si në vijim:

- Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/123 të datës 28.12.2016, ndarja buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 85,473€ në emër të kursimeve; dhe
- Brenda vitit 2016 në këtë kategori ekonomike janë alokuar donacione në vlerë prej 64,211€.

Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ishte në shumën 507,048€, ose në përqindje 97%.

Shpenzimet komunale: Me buxhetin fillestar buxheti i aprovuar për këtë kategori ishte 34,000€. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/123 të datës 28.12.2016, kjo ndarje buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 8,293€ në emër të kursimeve. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte në shumën 24,668€, ose shprehur në përqindje 96%.

Investime kapitale: Buxheti fillestar për këtë kategori ishte aprovuar në shumën prej 50,000€. Ndryshimet gjatë vitit në buxhetin fillestar janë si në vijim:

- Me Ligjin nr. 05/L-106 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, është shkurtuar ndarja buxhetore në shumën prej 21,700€; dhe
- Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 11/120 të datës 14.12.2016, është bërë shkurtimi buxhetor në shumën prej 15,319€.

Shkalla e realizimit për këtë kategori ekonomike ishte 12,981€, ose shprehur në përqindje 100%.

Donacionet e pranuar gjatë vitit 2016 nga partnerët e ZKA-së

- a) Bashkimi Evropian ka ndarë donacion prej 9,901€, për të bashkë-financuar Konferencën e VIII-të vjetore të organizuar nga ZKA-ja, në të cilën ka marrë pjesë stafi i ZKA-së, si dhe partnerët tanë vendor dhe ndërkombëtar;
- b) Qeveria Zvicerane (Projekti DEMOS), ka ndarë donacion prej 42,000€ për të financuar projektin "Në mbështetje të Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit për përmirësim të efikasitetit Institucional".
- c) Banka Botërore ka ndarë donacion, rimbursim 12,310€ nga shpenzimet e bëra në vitin 2015.

Struktura e buxhetit bazuar në buxhetin fillestar, ndryshimet gjatë vitit dhe shpenzimet e realizuara, janë paraqitur në tabelën në vijim:


Tabela 4: Struktura e buxhetit dhe e realizimit

në 000€

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
2016				
Buxheti i përgjithshëm	2,309	2,264	2,235	99.3%
Pagat dhe mëditjet	1,674	1,704	1,690	99.2%
Mallrat dhe shërbimet	551	521	507	97.3%
Shërbimet komunale	34	26	25	96.0%
Investimet kapitale	50	13	13	100.0%
2015				
Buxheti i përgjithshëm	2,213	2,234	2,203	98.6%
Pagat dhe mëditjet	1,574	1,613	1,613	100.0%
Mallrat dhe shërbimet	605	594	564	94.9%
Shërbimet komunale	34	27	26	97.2%
Investimet kapitale				0.0%
2014				
Buxheti i përgjithshëm	2,131	2,210	2,169	98.1%
Pagat dhe mëditjet	1,349	1,480	1,480	100.0%
Mallrat dhe shërbimet	712	666	644	96.7%
Shërbimet komunale	40	34	27	80.0%
Investimet kapitale	30	30	18	59.3%


RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Grafiku nr. 1: Shpenzimet nëpër kategori ekonomike



Grafiku nr. 2: Shpenzimet për mallra dhe shërbime

- Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit
- Shërbimet e arsimit dhe trajnimit
- Auditimi i komunave
- Shërbimet kontraktuese tjera
- Mirëmbajtje dhe sigurim
- Furnizim me derivate të naftës
- Furnizim me pajisje dhe material zyrtar
- Shpenzimet e qirasë
- Të tjera




Nga grafiku nr. 2 vërejmë që sikurse edhe viteve të kaluara, shpenzimet e qirasë mbeten kostoja më e lartë gjatë vitit 2016 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shprehur në përqindje 31%. ZKA vazhdon të ushtroj aktivitetin e saj në objektet private, përkundër zotimeve të Qeverisë për të gjetur një zgjidhje për vendosjen e ZKA-së në një objekt publik.

Shpenzimet tjera:

- 20 % e shpenzimeve kanë të bëjë me pagesat për udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Këto shpenzime kanë ndodhur si rezultat i rritjes së numrit të auditimeve në komunat të cilat janë 50km larg Prishtinës (vitin e kaluar 6 prej këtyre komunave janë audituar nga firmat e auditimit të nënkontraktuara nga ZKA), intensifikimit të bashkëpunimit të ZKA-së në nivel ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrjes së stafit në punëtori dhe konferenca jashtë Kosovës;
- 18% e shpenzimeve ka të bëjë me pagesat për blerje të pajisjeve të TI-së dhe furnizime për zyre.

Grafiku nr. 3: Shpenzimet nëpër kategori, krahasuar me buxhetin e shpenzuar



Nga grafiku nr. 3 mund të vërehet se shpenzimet në kategorinë e Pagave dhe mëditjeve kanë shënuar rritje për shkak të përfshirjes së AP-së në Listën e Pagave të ZKA-së⁴, si dhe angazhimit të dy punonjësve të përkohshëm. Ndërsa, shpenzimet në kategorinë për Mallra dhe shërbime nëpër vite kanë shënuar rënie, si rezultat i uljes së vazhdueshme të kostove operative.

⁴ Auditori i Përgjithshëm, deri në vitin 2015 ka qenë ndërkombëtar dhe është paguar nga grantet e donatorëve.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

2.4.2 Pasuritë

Blerjet e reja gjatë vitit 2016 janë si në vijim:

- Investime kapitale (pajisje mbi 1,000€), në shumën prej 12,981€, është blerja e sistemit VOIP të telefonisë fikse, duke e zëvendësuar sistemin e vjetër analog i cili ishte donacion që nga viti 2003;
- Investime jo kapitale (pajisje nën 1,000€), në shumën 63,127€, e cila shumë kryesisht paraqet vlerën e blerjes së 70 laptopëve dhe 70 monitorëve me performanca më të avancuara. Këto mjete të reja të TI-së pritet të kontribuojnë në ngritje të efikasitetit në punë të ekipeve audituese.

Të gjitha automjetet zyrtare të ZKA-së që nga viti 2013 në regjistrat kontabël të SIMFK-së kanë vlerën neto zero. Vjetërsia e tyre sillet prej 9 deri 11 vite.

2.5 Burimet njerëzore dhe trajnimet

Burimet njerëzore janë shtylla kryesore e ZKA-së, pasi që përmes tyre realizohen objektivat strategjike të institucionit. Me qëllim të rritjes së cilësisë në punë, dhe të kryerjes së më shumë auditimeve, kemi krijuar një qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore. Fokusi ynë është drejtuar në zhvillim profesional të kapaciteteve njerëzore, ku përmes ngritjes së vazhdueshme profesionale të punonjësve dhe ndërtimit të karrierës në ZKA, synojmë të forcojmë kompetencën në punën tonë profesionale.

Analizë e strukturës së burimeve njerëzore

Kufiri i lejuar i punonjësve për vitin 2016, sipas Ligjit të Buxhetit, është 146 punonjës. Në raport me vitin 2015, nuk ka pasur ndonjë rritje të theksuar në numrin e përgjithshëm të punonjësve. Në fund të vitit 2016 kemi pasur të angazhuar gjithsejtë 153 punonjës, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, nivelin e lartë drejtues, auditorët dhe personelin tjetër profesional dhe administrativ. Në këtë numër të punonjësve përfshihen edhe punonjësit e angazhuar përkohësisht, që kanë zëvendësuar personelin që gjendet në pushim të lehonisë.

Statistikat e personelit përgjatë viteve janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 5: Personeli nëpër vite

Viti	Kufiri i lejuar personelit	Numri i personelit nga komunitetet	Përqindja e femrave	Mosha mesatare	Numri i udhëheqësve të ekipit	% Lëvizja e personelit	Përvoja në zyrë më e gjatë se dy vite
2014	146	6	48.9%	38.1	43	1.36	137
2015	146	5	49.3%	37.9	42	1.36	138
2016	146	5	49.7%	39.0	33	0.00	143

Numri i punonjësve nga komunitetet tjera nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar.

Statistika gjinore sipas shënimeve nga tabela e mësipërme, është e ndarë në 50.3% meshkuj dhe 49.7% femërore. Përveç kësaj, edhe numri i femrave në pozita udhëheqëse në të gjitha nivelet është i konsiderueshëm.

Struktura e moshës së punonjësve të ZKA-së është relativisht e re, 59% të punonjësve janë nën moshën 40 vjeçare, por edhe mosha mesatare është nën 40 vjet. Ky është një tregues që ZKA është një institucion i ri dhe me potencial për zhvillim. Tabela e mëposhtme tregon strukturën e moshës të ndarë nëpër kategori.

Tabela 6: Struktura sipas moshës

Kategoritë e punonjësve	22 - 30	31 - 40	41 - 50	51 - 60	61 - 65
Niveli drejtues	1	9	13	2	0
Auditorët	23	49	19	13	2
Punonjësit mbështetës	0	9	7	6	0
Total	24	67	39	21	2

Numri i udhëheqësve të ekipeve të auditimit është më i vogël se sa në vitet paraprake për shkak të angazhimit të më shumë projekteve audituese për një ekip të auditimit. Ky ndryshim ka rrjedhë nga rishikimi i tërësishëm i procesit auditues, me qëllim të shfrytëzimit dhe maksimizimit të burimeve njerëzore që ka në disponim ZKA.

Lëvizja e punonjësve ndër vite, është relativisht e ulët. Gjatë vitit 2016, nuk ka pasur asnjë largim apo dorëheqje nga puna.

Mbi 93% të punonjësve kanë më shumë se dy vite përvojë me ZKA, gjë që dëshmon se punonjësit janë të pajisur me njohuritë dhe përvojat e nevojshme për mjedisin e punës së auditimit.

Gjatë vitit 2016, kemi bërë përpjekje që të kemi një strukturë të shëndoshë, të aftë dhe kompetente në kryerjen e detyrave udhëheqëse. Kemi kryer një vlerësim të tërësishëm institucional, ku përmes një përfshirjeje të gjerë të të gjithë punonjësve kemi realizuar një ri-organizim të përshtatur mbi nevojat reale institucionale, të bazuara edhe në kërkesat e jashtme për punën e auditimit.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të pozitive udhëheqëse në zyrën tonë, Këtu përfshihen nivelet drejtuese, niveli i mesëm drejtues, pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit, si dhe udhëheqësit e njësive profesionale – administrative.

Tabela 7: Pozitat drejtuese sipas gjinisë në të gjitha funksionet

Viti	Numri i drejtorëve (femra)	Përqindja %	Numri i drejtorëve (meshkuj)	Përqindja %	Numri i përgjithshëm i femrave në pozita udhëheqëse	Përqindja %	Numri i përgjithshëm i meshkujve në pozita udhëheqëse	Përqindja %
2014	7	43.8	9	56.2	26	40	39	60
2015	7	41.2	10	58.8	28	43.1	37	56.9
2016	7	36.8	12	63.2	25	41.7	35	58.3

Pas miratimit të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, kemi filluar punën për hartimin e akteve të brendshme për funksionim dhe organizim sa më të mirë institucional. Për këtë qëllim kemi themeluar grupet punuese të cilat janë në përbërje gjithëpërfshirëse institucionale.

Në fund të vitit 2016, ZKA kishte 128 auditorë, përfshirë menaxherët e nivelit të lartë drejtues (që trajtohen sipas ligjit të punës) si dhe 25 shërbyes civil.

Tabela 8: Kategoritë e personelit

Kategoria	2016		2015 ⁵		2014	
	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara
Niveli i lartë drejtues & Auditorët	128		123		120	
Shërbyesit civil	25		27		27	
Gjithsej	153 ⁶	146	150	146	147	140

⁵ Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri të ZKA-së, në qershor 2016, të gjithë punonjësit e ZKA-së janë trajtuar si shërbyes civil.

⁶ Numri aktual i auditorëve është më i lartë se sa kufiri i lejuar për shkak të angazhimit të përkohshëm të personelit për të zëvendësuar punonjësit në pushim të lehonisë.

Procesi i rekrutimit

Gjatë vitit 2016, kemi realizuar rekrutimin e dy punonjësve të përkohshëm, që janë angazhuar për të zëvendësuar punonjësit në pushim të lehonisë. Përveç kësaj, kemi organizuar dy procese rekrutimi për përkthyes të përkohshëm, që janë përfshirë për një periudhë deri në tre muaj për përkthimin e raporteve të auditimit. Ky angazhim është realizuar gjatë muajve prill – qershor 2016.

Përmes përkrahjes së projektit DEMOS – Helvetas Swiss, kemi angazhuar edhe dy këshilltarë për të ofruar mbështetje për Auditorin e Përgjithshëm. Fushat e angazhimit janë përkrahje për performancë institucionale dhe auditime të teknologjisë informative.

2.5.1 Trajnimi profesional i stafit

Zhvillimi i burimeve njerëzore, mbetet prioritet permanent i ZKA-së, pasi që besojmë se me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuojmë në cilësi më të mirë të punës, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës. Fokusi ynë është në edukimin e vazhdueshëm profesional, ku përmes trajnimeve të brendshme zhvillojmë njohuritë, dhe kompetencën e secilit punonjës në ZKA. Përveç tjerash, kemi vazhduar të investojmë edhe në zhvillimin e kapaciteteve drejtuese për nivelin menaxherial të ZKA-së.

Trajnimi i vazhdueshëm profesional

Plani i trajnimeve për vitin 2016 përmban një shtrirje të trajnimeve përgjatë gjithë vitit. Rezultatet e arritura tregojnë një ecuri të suksesshme të procesit të trajnimit, si mënyrë për zhvillimin profesional.

Gjatë vitit 2016, janë mbajtur një sërë trajnimesh e seminaresh të brendshme dhe të jashtme. Janë organizuar 26 trajnime të brendshme me tema të ndryshme si për zhvillim të aftësive profesionale, ashtu edhe të aftësive të buta. Në total, 118 punonjës kanë përfituar nga këto trajnime.

Në trajnimet dhe seminarët e jashtme të ofruara nga institucione vendore dhe ndërkombëtare kanë përfituar 60 punonjës. Këtu përfshihen edhe misionet për auditimet paralele të kryera në bashkëpunim me vendet e rajonit, dhe me mentorim nga ekspertët e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Po ashtu kemi përfituar edhe nga programi për Politika Publike dhe Leadership nga Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK), ku tre zyrtarë kanë përfunduar me sukses programin në fjalë.

Certifikimi i auditorëve

Në vitin 2016, kemi organizuar ceremoninë e certifikimit të auditorëve të sektorit publik. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, të institucioneve supreme të auditimit të rajonit, të shoqërisë civile dhe të botës. Ky aktivitet ka rezultuar me certifikimin e 100 auditorëve të ZKA-së. Përveç kësaj, në kuadër të kësaj ceremonie është organizuar edhe Tryeza me institucionet simotra nga rajoni me temën "Sfidat në zhvillimin institucional dhe të burimeve njerëzore në Institucionet Supreme të Auditimit".

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Tabela e mëposhtme paraqet gjendjen e personelit auditor sipas titujve funksional në bazë të certifikimit.

Tabela 9: Titujt profesional

Titulli funksional	2016	2015	2014
Auditor i Certifikuar i Sektorit Publik	57	48	27
Auditor i Sektorit Publik	35	36	31
Asistent Auditor i Sektorit Publik	11	12	28
Auditor në trajnim	6	11	20
Auditor të performancës	8	9	12
Auditor i brendshëm	7	1	1
Total	124	117	119



Fotografia 1: Ceremonia e certifikimit të auditorëve të sektorit publik

Sindikata e punëtorëve

Sindikata e punëtorëve ka zhvilluar normalisht aktivitetet sindikale. Menaxhmenti i ZKA-së i ka mundësuar kohën dhe kushtet për veprimtari sindikale. Për më tepër sindikata është angazhuar në procese të ndryshme të institucionit, duke përfshirë monitorimin e proceseve të punës, këshillëdhënien në grupe punuese si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta që për qëllim kishin organizimin e punonjësve apo festimin e ndonjë date të shënuar. Sindikata ka qasje në gjithë sistemin e intranetit të ZKA-së, dhe iu është lënë edhe hapësira e dedikuar për qëllime komunikimi me anëtarë të saj.

2.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit

Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit është një nga objektivat strategjike të ZKA-së, në mënyrë që të rrisë njohuritë e palëve të interesit, që ata të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e ZKA-së, si një institucion i pavarur i sektorit publik.

Prezenca në media

Gjatë vitit 2016, vërehet një rritje e dukshme e prezencës së ZKA-së në media gjatë tërë vitit, jo vetëm në periudhën e publikimit të raporteve. Ne kemi identifikuar rreth 365 artikuj me subjekt ZKA-në apo raportet e auditimit, krahasuar me 170 sa ishin në vitin 2015.

Për më tepër, raportet e auditimit shumë herë u morën për bazë nga televizionet kombëtare, të cilat janë përdorur si dokumente të besueshme dhe faktike.

ZKA shpreh vlerësim ndaj mediave të shkruara dhe elektronike, të cilat kanë mbuluar punën dhe aktivitetet e ZKA-së gjatë vitit 2016. Ato kanë publikuar artikuj të ndryshëm lidhur me raportet e auditimit, të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna në ato raporte, pastaj shqyrtimin e tyre në Kuvend dhe KMFP si dhe aktivitete, konferenca dhe punëtori të ndryshme të ZKA-së.

Bashkëpunimi me ISA-të partnere

Në zbatim të parimit “Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive”, ZKA-ja mban kontakte dhe ka zhvilluar marrëdhënie të mira me ISA-të në veçanti me ato të vendeve të Evropës dhe më gjerë.

Ky bashkëpunim ofron mundësi për të shkëmbyer pikëpamjet dhe për të ndarë përvojën me vendet tjera në përdorimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik. Bashkëpunimi me ISA-it tjera kryesisht zhvillohet përmes bashkëpunimit bilateral, Rrjetit të Presidentëve të ISA-ve të Regjionit, Komitetit të Kontaktit, INTOSAI dhe EUROSAI.

Edhe pse jemi pjesë aktive e këtyre organizatave dhe grupimeve, ZKA-ja në aktivitetet ndërkombëtare përfaqësohet në cilësinë e vëzhguesit, prandaj synimi primar në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është anëtarësimi me të drejta të barabarta në organizata përkatëse.

Aktivitet e bëra në vijim janë në zbatim të këtij parimi:

- **Pjesëmarrja për herën e parë në Kongresin INCOSAI** – Auditori i Përgjithshëm, mori pjesë në punimet e Kongresit të 22-të të INTOSAI-it i cili u mbajt në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe nga data 7-11 dhjetor 2016. Tema e këtij Kongresi ishte: “Si Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit mund të kontribuoj në agjendën e OKB-së 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, qeverisje të mirë dhe forcimin e luftës kundër korrupsionit?”;
- Vizitë pune në Zyren Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, me qëllim të njohjes më për së afërmi me praktikën e mira dhe mbështetjen që Auditori i Përgjithshëm i jep Parlamentit dhe Qeverisë në përmirësimin e manaxhimit të mirë dhe kontrollit në shpenzimin e parasë publike;
- Pjesëmarrja në Konferencën Rajonale “Zhvillimi i marrëdhënieve efektive të punës në mes të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve”, mbajtur në Ankara të Turqisë;

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

- Pjesëmarrja në takimin për projektin “Auditimet Paralele të Performancës II”, i cili u mbajt në Gjykatën Evropiane të Llogarive në Luksemburg, për përcaktimin e temës së auditimit me interes të përbashkët për vendet e rajonit;
- Takimi i Zyrtarëve Ndërlidhës të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE, i cili u mbajt në Sarajevë, për të përcaktuar Planin e Punës së Rrjetit;
- Pjesëmarrja në konferencën rajonale me temën “Përforcimi i performancës së institucioneve të pavarura: Roli i Parlamentit në Rajonin e Ballkanit Perëndimor”, të organizuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë;
- Vizitë pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë me qëllim të bashkëpunimit për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të ZKA-së si në sferën e auditimeve të rregullsisë dhe të performancës;
- Pjesëmarrja në Takimin Vjetor të Grupit Punues të EUROSAI, e organizuar nga Institucioni Suprem i Auditimit të Maqedonisë, me temën kontrolli i zhvillimit të qëndrueshëm që përfshinë aspektin ekonomik, social dhe mjedisor;
- Pjesëmarrja në takimin me përfaqësues të ISA-ve të rajonit, të mbajtur në Sarajevë, me temën “Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit”;
- Organizimi i punëtorisë rajonale me temën “Auditimi paralel i performancës në fushën e prokurimit publike”;
- Pjesëmarrja në punëtorinë rajonale “Formimi i Opinioneve të Auditimit dhe trajtimi i materialitetit”;
- Takime pune me Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, me temën “Vlerësimin e performancës financiare në ofrimin e shërbimeve dhe llogaridhënies në nivelin lokal”; Takim pune me udhëheqës të Qendrës për Fuqitë në Rritje të Universitetit të Kembrixhit, me temën “Dizajnimi i një programi ekzekutiv të edukimit për politika publike dhe të një skeme certifikimi për auditorët e performancës”;

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral Auditori i Përgjithshëm ka pritur për vizitë zyrtare, delegacionin e Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, dhe delegacionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë.

Konferenca Vjetore

Në korrik të vitit 2016, është mbajtur konferenca e tetë vjetore e ZKA-së me temën “Roli i Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e llogaridhënies në Kosovë”. Kjo konferencë kishte për qëllim që të nxjerren mësimet nga përvojat dhe sfidat nga sezoni i përfunduar i auditimit dhe të bëhen përgatitjet për sezonin e ri auditues. Konferenca është përcjellë nga të gjithë punonjësit e ZKA-së, dhe përfaqësues nga Kuvendi, Qeveria, shoqëria civile, si dhe organizatat donatore.

Për të zhvilluar më tutje bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe për të shkëmbyer pikëpamjet lidhur me përvojat, sfidat dhe qasjen në të ardhmen, ZKA-ja ka ftuar në Konferencën e VIII-të Vjetore partnerët nga ISA-të e vendeve të rajonit.

3 Fokusi i aktiviteteve të ZKA-së gjatë vitit 2017

Viti 2017 do të jetë vit i sfidave për ZKA-në, që kanë të bëjnë me aspektet strategjike të menaxhimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të organizatës. Gjatë vitit 2017 veprimtaria e ZKA-së do të fokusohet në fushat në vijim:

Aktivitetet audituese

- Përfshirja e të gjitha organizatave buxhetore në auditimet e detyrueshme të rregullsisë;
- Dyfishimi i numrit të auditimeve të Ndërmarrjeve Publike;
- Rritja e numrit të auditimeve të performancës;
- Auditimet e para të projekteve që financohen nga huamarrja shtetërore (projektet e financuara nga Banka Botërore);
- Auditimi i projekteve që financohen nga donatorët (sipas kërkesës).

Korniza ligjore, standardet dhe zhvillimi profesional

- Finalizimi i legjislacionit sekondar në pajtim me Ligjin e ri për Zyren Kombëtare të Auditimit dhe zbatimi i udhëzuesve të brendshëm që burojnë nga legjislacioni i ri;
- Ngritja dhe forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme administrative dhe menaxhimi efikas i ndryshimeve;
- Krahas zgjerimit të gamës së produkteve, ZKA duhet të rris burimet njerëzore dhe të zhvilloj më tej kapacitetet profesionale. Edukimi i vazhdueshëm profesional përmes trajnimeve specifike dhe implementimit të skemave profesionale të certifikimit të auditorëve. Përveç trajnimeve të brendshme stafi i ZKA-së do të ndjekë edhe trajnime dhe aktivitete profesionale që organizohen nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe organizatat partnere, si: EUROSAL, Gjykata Evropiane e Llogarive, Institucioni Suprem i Auditimit të Suedisë. Synohet pjesëmarrja edhe në aktivitetet Institucionit Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- Përcjellja e standardeve të reja me qëllim të ruajtjes së konsistencës dhe zhvillimit të auditimeve në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Rishikimi i doracakëve për auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe të pakove të letrave të punës;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë, përmes kontrolleve të shtuara me rastin e hartimit të planeve dhe programeve të auditimit dhe rishikimit të raporteve individuale të auditimit si dhe Raportit Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës. Ndërlidhja e cilësisë së punës me vlerësimin e performancës së auditorëve dhe rrjedhimisht me kategorizimin e auditorëve sipas niveleve senior, auditor, junior, teknik auditimi, etj.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Bashkëpunimi dhe kultivimi i marrëdhënieve me palët e interesit në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare

- Do të thellohet më tej bashkëpunimi me Kuvendin me qëllim të rritjes së llogaridhënies në institucionet publike dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit
 - Do të vazhdohet me përgatitjen e përmbledhjeve të raporteve individuale të auditimit për nevoja të komisioneve parlamentare;
 - Do të intensifikohet pjesëmarrja në takimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe ofrimi i këshillave dhe sqarimeve të nevojshme për anëtarët e komisioneve të Kuvendit për çështjet e raportuara në raportet e auditimit;
- Thellimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile (SHC). Synohet themelimi i një Forumi konsultativ me shoqërinë civile që do të përfshinte, universitetin publik, kolegjet private, shoqatat profesionale të auditimit, OJQ-të e fushës, mediat, etj dhe do të shërbente për shkëmbimin e ideve dhe për ngritjen e iniciativave nga SHC për përmirësimin e mëtejshëm të auditimit të jashtëm në Kosovë dhe për përkrahjen ZKA-së sidomos për auditime të performancës;
- Thellimi i bashkëpunimit me organizatat donatore:
 - Planifikohet fillimi i zbatimit të projektit të binjakëzimit që financohet nga **Bashkimi Evropian** me fokus në përmirësimin e pakos së letrave të punës dhe ngritjen e kapaciteteve për auditimin e ndërmarrjeve publike;
 - Bashkëpunimi me **USAID** në kuadër të projektit kundër korrupsionit, përkrahja për integrimin e ZKA-së në mekanizmat ndërkombëtar të ISA-ve, etj;
 - Fillimi i zbatimit të projektit të financuar nga **Banka Botërore** për fuqizimin e kapaciteteve të ZKA-së për auditime të prokurimit;
 - Bashkëpunimi me **GIZ** për përkrahjen e komisioneve parlamentare; dhe
 - Bashkëpunimi me **DEMOS** (projekt i Ambasadës Zvicerane në Kosovë për përkrahjen e 17 komunave të Kosovës) për rritjen e numrit të auditimeve të teknologjisë informative, etj.
- Intensifikimi i bashkëpunimit bilateral me institucionet supreme të auditimit:
